

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Xhuvi Sarxhi mori leje për 8 kate, po ndërton pallat 12 kate. Prestanome e kunatit të Bashës (Erion Isufi)?
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/16/xhuvi-sarxhi-mori-leje-per-8-kate-po-nderton-pallat-12-kate-prestanome-e-kunatit-te-bashes-erion-isufi/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 08:43:50 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 08:40:51 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e0e848a83d24b03cb9bbf431b3a58743defb0adeb64f2ae4896e86d1cd52c495
TEKSTI	b4cb2d76c3e620df6f428616b6ef6dddd96a8030af569f72b0a3e6d8ca68c212
PAMJA	621e4c6135ea14aeefbba24f7e59628440eb0a769d2aa1eb0a429953e99b6e9b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	455ab7d2fd35817af9349c0194cccf0caf46195a5cf3fe9ea3ac4ac71afe1d9
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	479381fa2a49a22c779ba6938b50ec298f3d05b6f6a0c36ab6b39ef80d1b34ab
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/455ab7d2fd35817af9349c0194cccf0caf46195a5cf3fe9ea3ac4ac71afe1d9>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Xhuvi Sarxhi mori leje për 8 kate, po ndërton pallat 12 kate. Prestanome e kunatit të Bashës (Erion Isufi)?

Kryesore

Publikuar: 16/09/2026



Me të lexuarat



"Punë oligarkësh", apo jo z. zëvendësministër?



Topçiu i Maliqit skemë korrupsioni me Shpresa Nikën e Shkodrës? Tendra pa



plotësuar kushtetuesja kriteret dhe ishte jo proporcional, Gjykata e Lartë lë në burg kryebashkiakun



punësi për sioneve dyfishohet nga 1 janari/ Të ardhurat e pensionistëve shtohen me



Çekrezi i lidhur me krimin e organizuar, Genti Shala fshehu pasurinë...

Para pak ditësh, redaksia e Vox News publikoi një investigim për një leje ndërtimi, të dhënë në mes të një lagjeje ekzistuese në zonën e ish-Parkut të Autobusëve, ku përfitues ishte ortaku i vjehrrit të Lul Bashës. Në dokumentet që hulumtoi Vox News, rezultoi se pallati do të ngrihej 12 kate mbi tokë dhe 2 kate nëntokë, ndërkohë që leja e dhënë nga qeveria është zbardhur kohët e fundit.

Ndërkohë, në redaksinë e Vox News kanë mbërritur të tjera informacione mjaft të dyshimta për dhënien e kësaj leje, ku rezultojnë se ndërtuesi apo ata që kanë firmosur lejen kanë bërë mashtrimin e radhës. Në zonën ku do të zhvillohet projekti, plani vendor i Bashkisë së Tiranës parashikon ndërtime deri në 8 kate, teksa leja e miratuar nga qeveria është plot 12 kate!

Por, si u dhanë 4 kate shtesë?! Në dokumentet që ka hulumtuar Vox News, ndërtuesi Sharxhi ka bërë një mashtrim për KKT-në apo edhe qeverinë, duke zvogëluar gjurmën e katit të parë. Planet vendore parashikojnë që, nëse një ndërtues zvogëlon koeficientin e ndërtimit, përshembull nga 60 % të sipërfaqes në 30 % të sipërfaqes, ai mund ta ngrejë në lartësi, për të "kompensuar" gjoja metrat që i shërbejnë qytetit.





Fig. 9 Visualizim i fasades.



Në foto: Maketi i pallatit 12 kate i miratuar nga KKT parashikon kolona në katin e parë, për të zvogëluar gjurmën e ndërtimit

Në lejen e ndërtimit është edhe maketi i kullës. Me sy të lirë shihet mjaft qartë se ndërtuesi ka një gjurmë të vogël të katit të parë, teksa katet e sipërme i ka zgjeruar. Por, ky është “mashtrimi” për ta ngritur në lartësi, pasi është justifikuar se gjurma që do të zërë në tokë është me koeficient të vogël, ndërkohë që katet e mësipërme zgjerohen.

“Parcela është 1106 metra katrorë dhe sipas PPV së Bashkisë Tiranë, që është dokument zyrtar në këtë zonë, në TR227 lejohen vetëm pallate 8 kate dhe 26 metra të

lartë me gjurmë kati përdhe 45% dhe projeksion të katit më të madh 55 % të parcelës. Sipas PPV, nëse ndërtuesi fiton bonusin 30%, mund të rritet maksimumi 11 kate me kushtin që gjurma e katit përdhe bëhet minus 6 % për çdo kat mbi 8 kate”, thotë një burim nga qeveria për këtë leje.

Sipas denoncuesve, KKT ka shpikur një hile që mund të quhet edhe e trashë por më tepër e pistë.

“Katin përdhe e bëjnë gjysmën, vetëm me kolona, dhe hapësira me kolona nuk llogaritet në gjurmë. Këtë rregull me shumë rezerva dhe vetëm për raste ekstreme në qendrat e qyteteve të mëdha, e kanë disa vende dhe kryesisht kur duhet ruajtur një trotuar ose duhet zgjeruar një trotuar”, pohojnë të njëjta burime.

Faksimile: Dokumenti i lejes së ndërtimit parashikon edhe Planin Vendor të Bashkisë së Tiranës (lejohen 8 kate dhe jo 12 kate)

Me këtë “stil” të trashë dhe të pacipë, e gjithë Tirana mund të mbushet 100% me ndërtime, duke bërë këtë marifet, ku gjoja kati i parë do të bëhet lulishte mbi soletën e parkimit nëntokësor dhe nën soletën e kateve sipër.

“Këtu e kanë quajtur gjysmën e gjurmës arkade dhe hapësirë rekreative me pemë, mbi soletën e parkimit dhe poshtë soletës së katit të parë”, vijon burimi.

Me këtë mashtrim ndërtuesi ka shtuar katet dhe ka dyfishuar sipërfaqet e kateve sipër, teksa nga llogaritet e bëra rezulton se aktualisht do të ndërtohen 5776 metra katrorë mbi tokë në vend

të 3960 metra katrorë. Pra, diferenca vetëm nga intensiteti është plot 1816 metra katrorë, metra të cilat firma i ka reklamuar me 2200 euro (4 milionë euro).

“Qeveria, përveçse ka sjellë një fitim të paligjshëm plus 4 milionë euro, ka ngushtuar distancat me pallatet ngjitur, sepse quan gjurmën e vogël dhe jo fasadën gjigande me projeksion 540 m2”, pohojnë burimet.

Mësohet se në atë nën njësi nr.5 të zonës TR227 ishte planifikuar, dhe ligji i jep përparësi, një kopsht publik. Dhe, pa u ndërtuar apo gjetur sipërfaqja për kopshtin, ligji ndalon çdo zhvillim.

/Voxnews

TAG:

12 kate

8 kate

Erion isufi

kunati i bashës

Leje

Pallat

Xhuvi sarxhi

Të ngjashme

Lanë në burg Veliajn, Valbon Çekrezi i lidhur me krimin e organizuar, Genti Shala fshehu pasurinë, SHBA-BE kërkuar të shkarkohej nga detyra si i ko...

“Punë oligarkësh”, apo jo z.zëvendësministër?

E vetmja gjë që nuk ka ndryshuar është përndjekja politike ndaj Erion Veliajt

Prapaskena

‘Prapaskena’ lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. ‘Prapaskena’ është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuara me interesat klienteliste, krimit dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.’

Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

Kategoritë

- KREU INVESTIGIM
- KRIM & KORRUPSION
- DOSJE ROZË
- KRYESORE POLITIKË EKONOMI
- ANALIZË RAJON KULTURË SPORT

Email:

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

[Privacy Policy](#) | [Cookies](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.